

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE
CS-1117/3
Data, Datum/Date: 14 / 01 / 2023
Lirija, Podaci/Anex: - 3 -
PRISHITINE/A



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira - Department Slobodnih Profesija -
Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Committee

DPL.nr.31/2022

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevci dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbarduesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbarduesit privat si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në lidhur me veprimet përmbardimore në lëndën përmbardimore, P.nr.456/22, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, ,pala ankuese nga dhe Përmbarduesi Privat, me datë 22.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHEN Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, DPL-29/2022 i datës 18.11.2022 dhe ankesa e palës ankuese e datës 17.11.2022 si të **pabazuara**.

II. Përmbarduesi , si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në **nuk është përgjegjës** për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbardimore P.nr.456/2022.

A r s y e t i m

Me datën 17.11.2022 pala ankuese përmes të autorizuarit të tij,av. nga ka parashtruar ankesë ndaj përmbarduesit privat me pretendimin se përmbarduesi privat ka bërë shkelje të LPP-së dhe shkelje të Udhëzimit Administrativ MD-nr.01/2022,për Tarifat për Shpërblimet dhe Kompenzimet e Shpenzimeve të Përmbarduesve Privat,pasi në nenin 21 të LPP-së,lidhur me bazën e caktimit të përmbardimit gjatë caktimit të lartësisë së taksës së administrimit,fillimisht ka lejuar

edhe një produkt të overdraftit që është vetëm obligim i debitorit të parë e jo të debitorëve të tjerë dhe ka llogaritur taksën e administrimit sipas dëshirës së vet e jo duke përfillur udhëzimin mbi tarifatat. Mbi këtë është dashur që të taksohet si shumë vlera prej 331.98 euro e jo vlera prej 582.14 euro, me çka e ka ngarkuar debitorin më tepër, për të cilën sipas palës ankuese e ka pranuar edhe vet përmbaruesi se nuk është në rregull, por pasi është vendim i përmbaruesve kësajsoj edhe e ka llogaritur.

I ka propozuar komisionit që konform nenit 368 të LPP-së, të ndërmerren masa ndaj përmbaruesit privat në proporcion me shkeljet e bëra dhe mjetet të kthehen tek debitori.

Me datën 18.11.2022, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesionet të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, ka paraqitur në Komisionin Raportin Përfundimtar ndaj përmbaruesit privat, lidhur me veprimet përmbarimore për këtë lëndë.

Përmbaruesi Privat, në deklaratën e tij ka parashtruar se procedura përmbarimore është inicuar me propozim të kreditorit dhe bazë për këtë ka qenë kontrata e pengut e cila ka qenë e regjistruar në MTI. Sipas kësaj, kërkesë e kreditorit është sekuestrimi i pengut të regjistruar dhe jo iniciimi sipas debitorëve apo produkteve bankare.

Pretendimi sa i përket taksës së aplikuar dhe llogaritur, ka ardhur bazuar në tekstin e udhëzimit dhe sipas qëndrimit të Odës së Përmbaruesve që ka dalur nga punëtorja e odës për këtë temë.

I ka propozuar komisionit që të refuzohet ankesa e palës ankuese.

Në seancën dëgjimore të mbajtur para komisionit disiplinor me dt.22.12.2022, pala ankuese ka deklaruar se duke pasur frikën nga procedurat ligjore që kishin të bënin me banesën e tij, ka paguar një shumë prej 500 eurosh në bankë, ndërsa për përmbaruesin, sipas vendimit të përmbaruesit, ka qenë shuma prej 582 euro, kur i njejtë edhe është informuar për pagesë në llogari për shumën prej 593 euro. E gjithë kjo me arsyetimin se nga Oda e Përmbaruesve, aplikohet në këtë mënyrë.

I ka propozuar komisionit që të aprovohet ankesa dhe të refuzohet kjo lëndë si dhe që të njejtë t' i kthehen mjetet e paguara për sa i përket taksës së administrimit të përmbaruesit në shumën prej 593 euro, ngase sipas kësaj takse përmbaruesi ka marrë afër 300 euro më shumë, pasi i njejtë ka paguar 500 euro për kreditorin dhe 593 euro për taksën e administrimit të përmbaruesit që gjithsej janë 1093 euro.

I ka propozuar komisionit që të shqiptohet masë disiplinore ndaj përmbaruesit privat, konform nenit 368 të LPP-së.

Përmbaruesi në deklaratimin në seancë ka theksuar se nuk konsideron që ka tejkalim, sepse udhëzimi për tarifatat në tabelën 1 e ka një formulim me tekst në të cilën formulim nëse shikohet me kujdes askund nuk përmendet shprehja që kjo përqindje aplikohet vetëm në diferencë, por vetëm i shtohet kërkesëvlerës kryesore. Për sa i përket pretendimit të palës për shumën e taksës së administrimit 582.14, 11.80 cent ka qenë shënimi zyrtar gjë të cilën e kishte deklaruar edhe pala ankuese në këtë seancë kur e njejtë ka qenë në zyrën e përmbaruesit për të arritur marrëveshje për pagesë me këste.

Sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 21 ku pala ankuese konsideron se ndaj saj personalisht është ngarkuar edhe një overdraft, përmbaruesi privat ka sqaruar se procedura përmbarimore nuk është e drejtuar ndaj personave fizik si emra të përvetshëm, por në bazë të kërkesës së kreditorit

për sekuestrim të pengut sipas titullit përmbartimor, kontratë pengun e regjistruar, pra pengun që është i lënë për një produkt, kërkohet që të sekuestrohet, pavarësisht se ku gjendet ai.

Pas seancës dëgjimore, dëgjimit të palëve, Komisioni Disiplinor me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar se në këtë rast Përmbartuesi Privat, nuk është përgjegjës për asnjërin nga shkeljet disiplinore të përcaktuara me nenin 367 të LPP-së.

Këtë konstatim komisioni e bazon në dokumentin përmbartimor, kontratën e pengut, duke shquar edhe tekstin e udhëzimit të tarifave i cili nuk ka qenë i sqaruar me ndonjë komentim shtesë se si do duhej të llogaritej ajo shumë, Qëndrimin nga punëtorja që Oda e Përmbartuesve Privat ka dhënë dhe që ky Qëndrim ka hyrë në fuqi prej datës 14.06.2022 dhe do vlej deri në ndryshimin e rrethanave apo deri në pranim të ndonjë interpretimi zyrtar për tarifim ndryshe nga ana e institucioneve përkatëse të Republikës së Kosovës e që deri në momentin e krijimit të shpenzimeve të kontestuara, nuk ka pasur ndonjë plotësim sa i përket interpretimit të udhëzimit nga institucionet përgjegjëse apo ndryshim rrethanash sa i përket mënyrës së llogaritjes së atyre shpenzimeve

Mbi bazën e të dhënave si më lart, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARTUESIT PRIVAT

DPL.nr.25/2022 datë 22.12.2022

Kryesuesja e Komisionit Disiplinor

Manushe Karaçi



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.